



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

KOMISIONI I BUXHETIT, FINANCËS DHE TAKSAVE-TARIFAVE

Datë 22.12.2025

RAPORT VENDIMMARRJEJE

Projekt-vendimin (titulli i projektvendimit): PËR SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË QYTETIN E DurrësIT PËR VITIN 2026.

Baza ligjore:

Ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligji nr.9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare” i ndryshuar, Ligji nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligji nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre” i ndryshuar, Ligji nr. 57/2020 “Për pyjet” i ndryshuar, Ligji nr.131/2015, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, i ndryshuar, Ligji nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, Ligji nr.10465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligji nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, Ligji nr. 57/2025, datë 16.10.2025 Për menaxhimin e integruar të mbetjeve, Ligji nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, Ligji nr. 50/2023 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, VKM-së nr. 783, datë 10.11.2011 “Për procedurat e ndarjes së të ardhurave të taksës vjetore të mjeteve të përdorura me njësitë e vetëqeverisjes vendore”, VKM-së nr. 132, datë 7.3.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme”, VKM-së nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, VKM-së nr.408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së zhvillimit të territorit” i ndryshuar, VKM-së nr. 475, datë 30.07.2021 “Për bashkëpunimin e njësisve të vetëqeverisjes vendore me shërbimin veterinar”, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.1, datë 12.01.2007 “Për përcaktimin e veprimtarive që trajtohen si veprimtari, tregtare, apo shërbimi, ambulantë si dhe procedurat e regjistrimit të tyre në organin tatimor”, Udhëzim i Ministrit të Financave nr.32, datë 31.12.2013 “Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël” i ndryshuar, Udhëzim i Ministrit të Financave nr.26, datë 04.09.2008 “Për taksat kombëtare” i ndryshuar, Udhëzimit të Përbashkët (Ministrit të Financave dhe Ministrit të Drejtësisë) nr. 655/1, datë 06.02.2007 “Për përcaktimin e Uniformitetit të Standarteve Procedurale dhe të Raportimit të Sistemit të taksës vendore” si dhe legjislacionit të

aplikueshëm në fuqi, akteve nënligjore të miratuara në bazë dhe për zbatim të ligjeve të sipërcituara

Propozimi nga kryetari/këshilltarët/tjetër (Çfarë propozohet në projektvendim):

Kryetari i bashkisë, sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, i propozon Këshillit Bashkiak të shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore dhe të vendosë:

- I. Miratimin e Paketës Fiskale të integruar “Për Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore në qytetin e Durrësit për vitin 2026.

Ndryshimet paraqiten si më poshtë:

Ndryshim Nr. 1

Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit propozon ndryshimin e pikës A.1.3 në tabelën nr. 6 “Taksa e ndikimit në infrastrukture nga ndërtimet e reja”.

Ishte

Nr.	Llojet e ndërtimeve dhe investimeve	Njësia	Niveli i taksës së ndikimit në infrastrukture	
			Nj. Adm. Bashkia Durrës	Nj. Adm. Të Tjera
1	Ndërtime me funksion banimi apo shërbimi nga zhvillues me qëllim përfitimin, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo për përdorim publik.	Në % të çmimit të shitjes për m ²	8%	8%
2	Ndërtime për qëllime banimi vetjak	Në % të çmimit të vlerës së investimit	3%	3%
3	Ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, bujqësisë si Struktura Shërbimi Hotel, Bar Restorant, B&B, Zyra, Agroturizëm, Struktura akomoduese, Bujtina	Në % të çmimit të vlerës së investimit	3%	3%
4	Ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e industrisë si Kapanone, Magazina, etj.	Në % të çmimit të vlerës së investimit	3%	3%
5	Për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte.	Në % të vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar kur kjo	0.1%	0.1%

		kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit.		
--	--	---	--	--

Bëhet

A.1.3 Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja				
Nr	Llojet e ndërtimeve dhe investimeve	Njësia	Niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë	
			Nj. Adm. Bashkia Durrës	Nj. Adm. Të Tjera
1	1. Ndërtime të destinuara për qëllime banimi apo për njësi tregtimi nga zhvillues me qëllim perfitimi. Ketu përfshihen: Ndertime apartamente apo njesi banimi, B&B, Apart-Hotel, Vila, pjese te komplekseve te lejeve me tipologji te mikse, ku qëllimi është shitja apo dhënia me qera afatshkurter apo afatgjate. 2. Godina shërbimi të cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi: Shoëroom, Zyra brenda godinave te kapanoneve industrial të industrive te ndryshme. 3. Ndërtime zëvendësuese për qëllime banimi, të kushtëzuara për t'u ndërtuar si shkak i zbatimit të një kontrate koncensionare, e cila prek banesat ekzistuese, ndërtime të destinuara për qendra tregtare apo të biznesit	Në % të çmimit të shitjes për m ²	8%	8%
2	Ndërtime për qëllime banimi për përdorim vetjak nga individët	Në % të çmimit të vlerës së investimit	3%	3%
3	Ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit (Hotel, Agroturizëm, Bujtina), të industrisë (Kapanone, Magazina etj.), të ndërtimeve individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuar nga vetë individi	Në % të çmimit të vlerës së investimit	3%	3%

	apo me sipërmarrës, si dhe të ndërtimeve për qëllime publike;			
4	Struktura që destinohen për përdorim në sektorin bujqësor dhe blegtoral dhe për objektet sportive	Në % të çmimit të vlerës së investimit	1%	1%
5	Për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte.	Në % të vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit	0.1%	0.1%

Ndryshim Nr. 2

Drejtorja e Arsimit, Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare dhe Qendrës Kulturore të Fëmijëve Durrës, propozon rishikimin e tarifës së dhënies me qira të sallës së shfaqjeve të QKF. Aktualisht, tarifa është në masën 25,000 lekë/orë, e cila ka rezultuar kufizuese për realizimin e aktiviteteve kulturore dhe artistike, veçanërisht për fëmijët, institucionet arsimore dhe organizatat kulturore.

Për këtë arsye, propozohet që tarifa të rishikohet dhe të përcaktohet në masën 15,000 lekë/përshfaqje, si dhe administrimi i saj të realizohet nga Sektori i Rinisë dhe Sporteve, pranë Drejtorisë së Arsimit, Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare, Bashkia Durrës.

Ishte

Tabela 35 .Tarifat e Qendrës Kulturore të Fëmijëve

Nr.	Emërtimi	Niveli i Tarifës
1	Dhënie në përdorim e sallës së shfaqjeve.	25.000 lekë/ore

Bëhet

Tabela 35 .Tarifat e Qendrës Kulturore të Fëmijëve

Nr.	Emërtimi	Niveli i Tarifës
1	Dhënie në përdorim e sallës së shfaqjeve.	15.000 lekë/për shfaqje

Ndryshim Nr. 3

Qendra Ekonomike e Arsimit Durrës propozon që tarifa fikse prej 360 lekë/muaj/fëmijë e kopshteve dhe çerdheve të hiqet nga paketa fiskale që do të miratohet për vitin 2026, pasi të gjitha shpenzimet operative për paga, sigurime shoqërore, energji elektrike, ujë, transport, karburant, materiale, detergjentë, mirëmbajtje dhe shërbime të tjera mbulohen nga fondet e Buxhetit të Bashkisë Durrës.

Në total për vitin kalendarik 2025 shpenzimet janë:

Kopshte (me ushqim)

Shpenzime paga e sigurime: 183,383,000 lekë

Shpenzime operative: 92,739,000 lekë

TOTALI: 276,122,000 lekë

Çerdhe

Shpenzime paga e sigurime: 109,354,000 lekë

Shpenzime operative: 27,635,000 lekë

TOTALI: 136,989,000 lekë

Tarifa e ushqimit për drekën e fëmijëve të kopshteve dhe çerdheve nuk ka pësuar ndryshim nga vendimi i Këshillit Bashkiak i sipërcituar. Duke filluar nga viti 2019 çmimet e artikujve ushqimorë bazë kanë pësuar rritje të konsiderueshme që vazhdon edhe sot, me nivele nga 7% deri në 150%.

Sipas relacionit të QEA do të ndryshojnë tabelat nr. 39 dhe 40 si me poshte :

Ishte

Tabela 39. Tarifat e kopshteve

Emërtimi tarifës	Kopshte
Tarifë për ushqimin	170 lekë/ditë/fëmijë
Tarifë fikse	360 lekë/muaj/fëmijë

Tabela 40. Tarifat e çerdheve

Emërtimi tarifës	Çerdhe
Tarifë për ushqimin	165 lekë/ditë/fëmijë
Tarifë fikse	360 lekë/muaj/fëmijë

Bëhet

Tabela 39. Tarifat e kopshteve

Emërtimi tarifës	Kopshte
Tarifë për ushqimin	170 lekë/ditë/fëmijë
Tarifë fikse	0 lekë/muaj/fëmijë

Tabela 40. Tarifat e çerdheve

Emërtimi tarifës	Çerdhe
Tarifë për ushqimin	165 lekë/ditë/fëmijë
Tarifë fikse	0 lekë/muaj/fëmijë

Ndryshim Nr. 4

Drejtoria e Planifikimit të Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit (DPZHKT) paraqet këtë relacion për saktësimin e formulimit të pikës 3 dhe pikës 4 të Tabelës nr. 19 – “Tarifat e Drejtorisë së Planifikimit Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit”. Formulimi ekzistues krijon paqartësi në zbatim, pasi nuk përcakton qartë llojin e dokumentacionit apo dosjeve për të cilat aplikohet tarifa dhe drejtorinë kompetente që administron këto akte. Formulimi i saktësuar që propozohet:

Pika 3: “Tërheqje dokumenti teknik nga DPZHKT – 500 lekë/dokument.”

Pika 4: “Tërheqje e dosjes teknike të plotë nga DPZHKT – 5,000 lekë/dosje.”

Ishte

Tabelë 19. Tarifat e Drejtorisë së Planifikimit Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit

NR	EMËRTIMI	TARIFA
1.	Tarifë për shqyrtim kërkesë për leje zhvillimi në momentin e dorëzimit të kërkesës.	2,000 lekë
2.	Tarifë për shqyrtim kërkesë që në momentin e dorëzimit të kërkesës për leje ndërtimi.	5,000 lekë
3.	Tërheqje dokumentash nga arkivi i drejtorisë.	500 lekë/dokument
4.	Tërheqje të gjithë dosjes nga arkivi i drejtorisë.	5,000 lekë/dosje
5.	Aktet e kontrollit piketim, kuota +- 00 objekte nga 1 deri në 2 kate.	5,000 lekë
6.	Akte kontrolli piketim, kuota +-oo objekte deri në 3 kate.	10,000 lekë
7.	Akte kontrolli piketim, kuota +-oo objekte deri në 6 kate.	15,000 lekë
8.	Akte kontrolli piketim, kuota +-oo objekte mbi 6 kate.	25,000 lekë
9.	Akte kontrolli piketim, kuota +-oo për objekte industriale.	30,000 lekë
10.	Për objekte turistike (kur kanë më shumë se një njësi zhvillimi).	6,000 lekë x nr. e objekteve
11.	Akt kontroll karabina, sistemim i jashtëm për objekte nga 1 deri në 2 kate.	6,000 lekë
12.	Akt kontroll karabina, sistemim i jashtëm për objekte deri në 3 kate.	8,000 lekë
13.	Akt kontroll karabina, sistemim i jashtëm për objekte mbi 3 kate.	1,500 lekë /për çdo kat

14.	Tarifë për zbardhje dosje për objekte 1-2 kate.	5,000 lekë
15.	Tarifë për zbardhje dosje për objekte deri në tre kate.	8,000 lekë
16.	Tarifë për zbardhje dosje për objekte mbi 3 kate.	15,000 lekë
17.	Tarifë për certifikatë përdorimi.	30 lekë/m3
18.	Tarifë për rrjetet kabllore telefonike, ndërlidhëse, apo të shërbimit informatik.	1000 lekë/km në vit

Bëhet

Tabelë 19. Tarifat e Drejtorisë së Planifikimit Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit

NR	EMËRTIMI	TARIFA
1.	Tarifë për shqyrtim kërkesë për leje zhvillimi në momentin e dorëzimit të kërkesës.	2,000 lekë
2.	Tarifë për shqyrtim kërkesë që në momentin e dorëzimit të kërkesës për leje ndërtimi.	5,000 lekë
3.	Tërheqje dokumentash teknike nga DPZHKT	500 lekë/dokumenti
4.	Tërheqje e dosjes teknike te plotë nga DPZHKT	5,000 lekë/dosje
5.	Aktet e kontrollit piketim, kuota +- 00 objekte nga 1 deri në 2 kate.	5,000 lekë
6.	Akte kontrolli piketim, kuota +-oo objekte deri në 3 kate.	10,000 lekë
7.	Akte kontrolli piketim, kuota +-oo objekte deri në 6 kate.	15,000 lekë
8.	Akte kontrolli piketim, kuota +-oo objekte mbi 6 kate.	25,000 lekë
9.	Akte kontrolli piketim, kuota +-oo për objekte industriale.	30,000 lekë
10.	Për objekte turistike (kur kanë më shumë se një njësi zhvillimi).	6,000 lekë x nr. e objekteve
11.	Akt kontroll karabina, sistemim i jashtëm për objekte nga 1 deri në 2 kate.	6,000 lekë
12.	Akt kontroll karabina, sistemim i jashtëm për objekte deri në 3 kate.	8,000 lekë
13.	Akt kontroll karabina, sistemim i jashtëm për objekte mbi 3 kate.	1,500 lekë /për çdo kat

14.	Tarifë për zbardhje dosje për objekte 1-2 kate.	5,000 lekë
15.	Tarifë për zbardhje dosje për objekte deri në tre kate.	8,000 lekë
16.	Tarifë për zbardhje dosje për objekte mbi 3 kate.	15,000 lekë
17.	Tarifë për certifikatë përdorimi.	30 lekë/m3
18.	Tarifë për rrjetet kablore telefonike, ndërlidhëse, apo të shërbimit informatik.	1000 lekë/km në vit

Ky saktësim nuk sjell asnjë ndryshim në vlerën e tarifave të miratuara, por ka për qëllim vetëm qartësimin e fushës së zbatimit.

Ndryshim Nr. 5

Drejtoria e Shërbimeve Publike – Sektori i Transportit paraqet kërkesë për miratimin i tarifave të parkimit për godinën publike të parkimit multifunksional pranë stacionit të trenit Durrës, e realizuar si investim publik nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Durrës. Kjo kërkesë bazohet në Ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, VKM nr.153, datë 07.04.2000 “Për miratimin e Rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor”, VKB nr.127, datë 27.10.2022 “Për miratimin e draft marrëveshjes së bashkëinvestimit ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Bashkisë Durrës për projektimin, ndërtimin dhe menaxhimin e parkimit multifunksional pranë stacionit të trenit Durrës”, Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe VKB nr.66, datë 25.06.2024 “Për përcaktimin e zonave të administrimit të parkimit dhe tarifave të shërbimit të parkimit në territorin e Bashkisë Durrës”.

Në funksion të investimeve publike të realizuara dhe në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi, propozohet miratimi i tarifave të parkimit multifunksional pranë stacionit të trenit Durrës, sipas tabelës përkatëse, për t’u reflektuar në Paketën Fiskale të Bashkisë Durrës për vitin 2026.

Vendosja e këtyre tarifave synon rregullimin dhe eficiencën e përdorimit të parkimit, rritjen e transparencës dhe përmirësimin e menaxhimit të hapësirave publike. Për këtë arsye, propozohet që tabela e mëposhtme e tarifave të reflektohet në Paketën Fiskale 2026.

Tabela do t i shtohet tabelës nr. 22 Tarifë për parkimin e automjeteve në vendparkime publike me pagesë si pika 5 “Tarifa e Parkimit Multifunksional pranë stacionit të trenit”.

1. TARIFA E PARKIMI MULTIFUNKSIONAL PRANË STACIONIT TË TRENIT	
Fashat	Cmimi
0 – 1 orë	100
1 – 3 orë	200
3- 5 orë	300
5- 8 orë	400
8-24 orë	800

> 24 orë	800 +
Abonim Mujor	6000
Abonim Mujor 08:00-18:00	4000
Abonim Mujor 18:00- 08:00	3000

Ndryshim Nr. 6

Të ndryshojë struktura kompetente për kontrollin dhe vjeljen e zënies së hapësirës publike (ZHP), duke përcaktuar si strukturë përgjegjëse Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, pranë Bashkisë Durrës.

Vjelja e detyrimit për zënien e hapësirës publike do të kryhet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, e cila administron të ardhurat vendore dhe ndjek procedurat përkatëse financiare e tatimore, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Duke qenë se dhënia e lejes për zënien e hapësirës publike mbetet kompetencë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, pas miratimit të lejes përkatëse, procedurat administrative që lidhen me vlejën e pagesës dhe kontrollin në terren do të realizohen nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Kontrolli në terren për respektimin e kushteve të lejes, sipërfaqes së zënë dhe afatit të miratuar do të ushtrohet nga Sektori i Kontrollit, si strukturë operuese në terren pranë Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore. Ky ndryshim synon rritjen e eficiencës administrative, forcimin e kontrollit dhe garantimin e një administrimi më të efektshëm të taksës për zënien e hapësirës publike. Ndryshimi në paragrafin e fundit të tabelës nr. 23

Ishte

Për kategorinë 1, struktura përgjegjëse për dhënien e lejes për zënien e hapësirës publike, llogaritjen dhe arkëtimin e taksës është Drejtoria e Shërbimeve Publike, pranë Bashkisë Durrës.

Struktura përgjegjëse për vjeljen e taksës është Drejtoria e Shërbimeve Publike pranë Bashkisë Durrës. Për kategorinë 2 dhe 3, struktura përgjegjëse për dhënien e lejes së zënies së hapësirës publike llogaritjen dhe arkëtimin është Drejtoria e Shërbimeve Publike, pranë Bashkisë Durrës.

Bëhet

Për kategorinë 1, struktura përgjegjëse për dhënien e lejes për zënien e hapësirës publike, llogaritjen dhe arkëtimin e tarifës është Drejtoria e Shërbimeve Publike, pranë Bashkisë Durrës.

Për kategorinë 2 dhe 3 struktura përgjegjëse për dhënien e lejes së zënies së hapësirës publike llogaritjen dhe arkëtimin është Drejtoria e Shërbimeve Publike, pranë Bashkisë Durrës. Struktura përgjegjëse për vjeljen dhe Kontrollin në terren të tarifës është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Ndryshim Nr. 7

Në faqen nr. 52 të Paketës Fiskale tek pika **“Përcaktime”** paragrafi i fundit do të shtohet një përcaktim në lidhje me firmat ndërtimit dhe të saktësohet vjelja e taksës së truallit. Në vijimësi do të bëhet ky ndryshim:

Ishte

Për firmat e ndërtimit kur subjekti me ose pa seli në Durrës ka disa adresa sekondare me aktivitet “ndërtim”, do të ngarkohet me tarifat vendore (pastrim, gjelbërim, ndriçim, parkim Zona A) vetëm për një adresë.

Bëhet

Për firmat e ndërtimit kur subjekti me ose pa seli në Durrës ka disa adresa sekondare me aktivitet “ndërtim”, do të ngarkohet me tarifat vendore (pastrim, gjelbërim, ndriçim, parkim Zona A) vetëm për një adresë. Për çdo kantier ndërtimi, në përputhje me lejen përkatëse të ndërtimit të miratuar nga autoriteti kompetent, do të aplikohet taksa e truallit e cila lind si detyrim tatimor nga data e fillimit të punimeve ndërtimore, sipas deklaramit dhe verifikimit nga strukturat përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi.

Ndryshim Nr. 8

Në vijim të kërkesës së paraqitur nga Shoqëria Rajonale e Ujësjellës-Kanalizimeve Durrës sh.a. (SHRUKD), nr. 7107 Prot. datë 18.12.2025 si dhe në kuadër të rinovimit të kontratës për ushtrimin e funksionit të agjentit tatimor për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore, paraqitet për shqyrtim dhe miratim pranë Këshillit Bashkiak ky propozim.

Aktualisht, SHRUKD sh.a. përfiton një kompensim në masën 2% të shumës së arkëtuar për shërbimin e mbledhjes së taksave dhe tarifave vendore. Duke marrë në konsideratë kërkesën e SHRUKD sh.a., si dhe nevojën për të garantuar vijimësinë të këtij shërbimi, propozohet rishikimi i përqindjes së kompensimit. Përsa më sipër, propozohet që përqindja e kompensimit të ndryshohet nga 2% në 4% të shumës së arkëtuar. Për rrjedhojë, i propozohet Këshillit Bashkiak të Bashkisë Durrës miratimi i ndryshimit të përqindjes së kompensimit për SHRUKD sh.a. nga 2% në 4%, sipas kushteve që do të përcaktohen në kontratën e rinovuar ndërmjet palëve.

Analiza Financiare/ Buxheti total/natyra e financimit (të ardhurat e veta, transferta etj):

Fonde nga të ardhurat e veta.

Drejtoria/Spektori përgjegjës që ka përgatitur materialin:

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Impakti social/grupet që preken:

Banorët e Bashkisë Durrës.

A është objekt konsultimi: (PO/JO)

Po. Konsultimi është bërë sipas kalendarit të publikuar në faqen zyrtare web të bashkisë Durrës dhe në rrjetet sociale të këshillit bashkiak, përkatësisht në Njësitë Administrative dhe në bashkinë qendër.

Komisioni i përhershëm/përkohshëm i Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave, u mbledhë më datë 22.12.2025, dhe shqyrtoi pikën nr. 3 të rendit të ditës, relacionin dhe dokumentat shoqërues të tij.

Komunikimi midis administratës dhe komisionit i përhershëm/përkohshëm:

Kryetari - Drejtori nese ka pyetje per pike
3 te rendit detyrohet te shkoje ne fiske.
U be nje pyetje nga Jozeta Mamo per
taksen e kapshme. nga Jozeta Mamo per
fiska te shpallur nga Drejtoria e punimeve,
qte perfaqsohet me miratim Udhzime te komisionit.

Për sa më sipër, pas shqyrtimit, të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese, Komisioni me shumicë votash, vendosi:

T'i propozojnë Këshillit Bashkiak:

- a- Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim
- b- Miratimin e projekt aktit
- c- Refuzimin e miratimit të projektaktit
- d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si vijon:
- e- _____

Komisioni i Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave

Kryetar	Rolant Xhelilaj
Zv/Kryetar	Erzen Laçi
Sekretar	Hekuran Markola
Anëtar	Jonada Mamo
Anëtar	Alfred Mullaraj
Anëtar	Denisa Luarasi
Anëtar	Silvana Agasi
Anëtar	Dritan Burgija
Anëtar	Jonuz Myshketa
Anëtar	Xhojana Gjineci
Anëtar	Kontjana Kuçi

PRO

PRO

PRO

PRO

PRO

PRO

PRO